

URDHËR
Nr. 112, datë 21.5.2025

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimit nr. 725, datë 2.9.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, urdhrit të Kryeministrit nr. 1, datë 8.1.2025, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Zhvillimit të Territorit”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të drejtorit të përgjithshëm vetëm për nënshkrimin e akteve të cilat depozitohen pranë gjykatave kompetente, te znj. Alisa Basha me pozicion drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Shqyrtimit të Aplikimeve.

2. Kompetenca e deleguar sipas pikës 1 të këtij urdhri, do të ushtrohet nga data e hyrjes në fuqi të tij deri më datë 30.6.2025.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri znj. Alisa Basha dhe Drejtoria Juridike dhe Shqyrtimit të Aplikimeve pranë Agjencisë së Zhvillimit të Territorit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Adelajda Roka